

## Zyra e Gjendjes Civile

Komuna e Gjakovës

për

### Komisionin e Ankesave

#### Agjencia për Regjistrimin Civil

Ministria e Punëve të Brendshme

Rr. Luan Haradinaj p.n.

10000 Prishtinë

Republika e Kosovës

Lënda: Ankesë ndaj Vendimit të Zyrës së Gjendjes Civile në Gjakovë për Refuzimin e Kërkesës për Ndërrimin e Emrit dhe të Shënuesit të Gjinisë

Nga: Blerta Morina, përfaqësuar sipas autorizimit nga Avokatja Rina Kika, me seli në Rr. Miss Edith Durham B1 H1 Nr.11, Prishtinë 10000 – Kosovë

Data: 29 maj 2018

Duke u bazuar në nenin 124, paragrafi 1 dhe 2 i Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe nenit 19 të Udhëzimit Administrativ (MPB) Nr.19/2015 për Kushtet dhe Procedurat e Ndërrimit dhe Korrigjimit të Emrit Personal, Ankuesi brenda afatit ligjor e parashtron këtë:

## ANKESË

ndaj

**Vendimit Nr.02-201-02-8319 të datës 26.04.2018 të nxjerrë nga Zyra e Gjendjes Civile në Gjakovë për Refuzimin e Kërkesës për Ndërrimin e Emrit nga "Blerta" në "Blert" dhe Ndërrimit të Shënuesit të Gjinisë nga "F" në "M"**

1. Më datë 4 prill 2018, Blerta Morina, (në vazhdim "**Ankuesi**") ka parashtruar Kërkesë pranë Zyrës së Gjendjes Civile në Gjakovë, me të cilën ka kërkuar që t'i ndërrohet emri nga "**Blerta**" në "**Blert**" dhe t'i ndërrohet shënuesi i gjinisë nga "**F**" në "**M**" në Regjistrin e Gjendjes Civile dhe në të gjitha dokumentet e identifikimit, ashtu që emri dhe shënuesi i gjinisë të jenë në përputhje me identitetin e tij gjinor.
2. Më datë 16 maj 2018, Ankuesi ka pranuar Vendimin e Komisionit të Zyrës së Gjendjes Civile në Gjakovë, i nxjerrë më datë 26 prill 2018, me të cilin Komisioni kishte vendosur që ta refuzojë kërkesën e parashtruar për ndërrimin e emrit dhe të shënuesit të gjinisë (në vazhdim "**Vendimi refuzues**").

3. Vendimi refuzues i Zyrës së Gjendjes Civile duhet të anulohet nga Komisioni i Ankesave të Agjencionit për Regjistrimin Civil sepse është i paligjshëm dhe diskriminues. Përkatësisht, Vendimi është i paligjshëm sipas nenit 52, paragrafit 1.1, 1.4 dhe 1.5 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (në vazhdim: "**Ligji për Procedurën Administrative**").
4. **Së pari**, Vendimi refuzues është i paligjshëm sipas nenit 52, paragrafit 1.1, sepse nxjerrë në mungesë të autorizimit nga një ligj, nenit 4, paragrafi 2 të Ligjit për Procedurën Administrative duke qenë se e ka refuzuar kërkesën duke u bazuar në një bazë inekzistente ligjore – pra pa pasur autorizim nga një bazë ligjore.
5. **Së dyti**, Vendimi refuzues është i paligjshëm sipas nenit 52, paragrafit 1.4 të Ligjit të Procedurës Administrative pasi që është njërrë në kundërshtim me dispozitat që rregullojnë formën apo elementet e detyrueshme të aktit administrativ, kjo për shkak se Komisioni i Zyrës së Gjendjes Civile ka dështuar të ofrojë arsyetimin në përputhje me nenin 48 të Ligjit për Procedurën Administrative.
6. **Së treti**, Vendimi refuzues është i paligjshëm sipas nenit 52, paragrafit 1.5 të Ligjit për Procedurën Administrative, sepse është nxjerrë në kundërshtim me ligjin material dhe është diskriminues, përkatësisht është nxjerrë në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, Ligjin Nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore (në vazhdim "**Ligji për Barazi Gjinore**"), Ligjin Nr.05/L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi (në vazhdim "**Ligji për Mbrojtje nga Diskriminimi**"), Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut, Paktin për të Drejtat Civile dhe Politike, Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

## **I. VENDIMI PËR REFUZIMIN E KËRKESËS ËSHTË NXJERRË NË MUNGESË TË AUTORIZIMIT NGA NJË LIGJ**

7. Vendimi refuzues i Komisionit të Zyrës së Gjendjes Civile është nxjerrë në mungesë të autorizimit nga një ligj sipas nenit 4, paragrafit 2 të Ligjit për Procedurën Administrative sepse me këtë Vendim është cënuar një e drejtë ndërsa Komisioni është mbështetur mbi një bazë inekzistente gjatë marrjes së Vendimit. Pra e drejta e Ankuesit për tu njohur para ligjit në bazë të identitetit të tij gjinor me emrin dhe gjininë me të cilën ai identifikohet është cënuar duke u mbështetur nga një bazë e cila nuk është e autorizuar nga një ligj. Rrjedhimisht, Vendimi refuzues është nxjerrë në kundërshtim me nenin 4, paragrafin 2 të Ligjit për Procedurën Administrative i cili përcakton si vijon:

**"Veprimi Administrativ që cënon apo mund të cënojë një të drejtë apo interes juridik të një personi, duhet të jetë i autorizuar nga një ligj".**

8. Në arsyetimin e Vendimit refuzues në fjalë theksohet si vijon:

"Shtetasja nuk i plotëson kushtet dhe procedurat e Ndërrimit dhe Korrigjimit të Emrit Personal, Komisioni ka vlerësuar se arsyeshmëria e ofruar nga parashtruesja e kërkesës nuk qëndron dhe nuk e përmbush qëllimin e nenit 6, paragrafit 1, nënparagrafi 1.8, pasi që emri "Blerta" nuk e pengon integrimin e personit në shoqëri në Republikën e Kosovës, me Udhëzimin Administrativ (MPB) nr.19/2015,.. nga shkaqet e arsytet e cekura më lartë u vendos si ne dispozitivin e këtij Vendimi."

9. Neni 12, i Ligjit Nr.02/L-118 për Emrin Personal (tutje referuar si "**Ligji për Emrin Personal**") përcakton si vijon:

“Qytetari i moshës madhore mund ta ndërrojë emrin personal në bazë të kërkesës së tij.”

10. Më tej, neni 18 i Ligjit për Emrin Personal përcakton rastet të cilat paraqesin pengesa për ndërrimin e emrit personal për qytetarët e moshës madhore në një listë taksative, pra një listë e mbyllur. Asnjëri nga rastet e përmendura nuk e përcakton mungesën e arsyeshmërisë së kërkesës për ndërrimin e emrit si bazë ligjore për refuzimin e kërkesës për ndërrimin e emrit personal. Lista taksative e pengesave në nenin 18 të Ligjit për Emrin Personal numron këto raste:

### **Neni 18**

#### **Pengesat për ndërrimin e emrit personal**

“18.1. Qytetarit kundër të cilit zhvillohet procedura për vepër penale për të cilën ndiqet sipas detyrës zyrtare i cili është dënuar për vepër të këtillë penale, derisa nuk i është ekzekutuar dënimi ose gjithnjë derisa të vazhdojnë pasojat juridike të dënimit, si dhe as personit për të cilin konstatohet se kërkesën e ka paraqitur për t’iu shmangur detyrimeve të përcaktuara me ligj, nuk do t’i lejohet ndërrimi i emrit personal.

18.2. Nëse emri personal i është ndërruar qytetarit, kundër të cilit zhvillohet procedura penale për vepër penale, zyra e gjendjes civile që në

afatin prej tre ditësh pas aprovimit të ndërrimit duhet ta njoftojë gjykatën në të cilën zhvillohet procedura penale.

18.3. Zyra e regjistrimit civil mund të kërkojë nga Gjykata dhe Prokuroria verifikimin e vërtetësisë të të dhënave të parashtruara nga aplikuesi lidhur me dokumentet nga neni 17 i këtij ligji.

18.4. **Nëse emri personal është ndërruar** me kërkesë të palës në procedurë administrative të organit të gjendjes civile, **për pesë vitet e ardhshme, palës nuk do t'i lejohet sipas së njëjtës procedurë ndërrimi i serishëm i emrit personal nga organi i gjendjes civile.”**

11. Pra, bazat e përmendura më sipër janë bazat mbi Zyra e Gjendjes Civile mund të nxjerrë vendim refuzues ndaj kërkesës për ndërrim të emrit. Asnjëra nga bazat e mësipërme nuk e përcakton se mungesa e arsyeshmërisë së kërkesës paraqet bazë për refuzimin e kërkesës për ndërrim të emrit. Siç u përmend edhe më sipër, lista e nenit 18 të Ligjit për Ndërrimin e Emrit Personal është taksative pra e përmban një listë të bazave konkrete të refuzimit të kërkesës për ndërrimin e emrit personal. Prandaj Zyra e Gjendjes Civile nuk mund ta shpikë një bazë të re për refuzimin e kërkesës, dhe çfarë do baze tjetër e refuzimit është jashta listës së nenit 18 bie në kundërshtim me Ligjin për Ndërrimin e Emrit Personal. Ligji përkatës madje nuk përcakton në asnjë dispozitë që kërkon nga Ankuesi arsyetimit të kërkesës për ndërrimin e emrit.

12. Deklarimi i arsyes për ndërrimin e emrit përcaktohet në nenin 6 të Udhëzimit Administrativ për Ndërrimin e Emrit ku theksohet se janë gjithsej 11 arsye për të cilat mund të kërkohej ndërrimi i emrit. Mirëpo është e qartë se karakteri i listës së arsyeve të përmendura në Udhëzimin Administrativ për Ndërrim të Emrit është vetëm deklarativ. Udhëzimi Administrativ në nenin 6 i emron arsyet për të cilat shtetasi i Kosovës mund të kërkojë ndërrimin e emrit, mirëpo në asnjë dispozitë nuk përcakton se kërkesa për ndërrimin e emrit do të refuzohet në rast se arsyeja e dhënë konsiderohet se nuk qëndron nga Zyra për Gjendjen Civile. Vetë fakti se tek paraqitja e kërkesës për ndërrimin e emrit personal nuk është e nevojshme të dorëzohet një kërkesë me arsyetim narrativ për personin që kërkon ndërrimin e emrit paraqet dëshmi të mjaftueshme për karakterin deklarativ të arsyes për ndërrimin e emrit. Ankuesi në rastin konkret ka paraqitur ankesën në formë narrative me vetëdëshirë bashkë me formularin e plotësuar të kërkesës së gatshme ku ka shënuar arsyeja e paraqitjes së kërkesës: emri e pengojnë integrimin e tij në shoqëri.

13. Kërkesa për ndërrim të emrit bëhet me plotësimin e një formulari i cili mund të gjindet te Shtojca 1 e Udhëzimit Administrativ për Ndërrimin e Emrit Personal dhe bashkëngjitjen e

dokumentave që kërkohen për të dëshmuar se personi nuk është në hetime, se nuk është dënues për veprë penale dhe se nuk ka obligime të papaguara ndaj shtetit. Në formularin/shtojcën e kërkesës shënohen këto informata: emri i komunës ku parashtrohet kërkesa, data dhe numri i protokolimit, të dhënat personale të personit që kërkon ndërrimin e emrit, emri i ri personal i aplikuesit, ndërsa në faqen e fundit duhet të plotësohet katrori përkrah arsyeve për ndërrimin e emrit personal të numëruara në listë. Aplikuesi për ndërrim të emrit thjeshtë duhet të deklarojë arsyen për të cilën është duke parashtruar kërkesën për ndërrim të emrit, duke e mbushur katrorin përkrah arsyes që i përgjigjet atij.

14. Sa i përket refuzimit të kërkesës për ndërrimin e shënuesit të gjinisë, Komisioni i Zyrës së Gjendjes Civile nuk ka cekur asnjë bazë ligjore e cila do të mund të merrej për bazë për refuzimin e kërkesës. Këtu duhet të theksohet sërish se kemi të bëjmë me një vendim i cili e cënon të drejtën e Ankuesit në njohjen ligjore të identitetit të tij gjinor dhe në respektimin e jetës së tij private. Shkeljet tjera të së drejtës materiale të cilat i ka bërë Komisioni për Zyrën e Regjistrimit Civil me nxjerrjen e Vendimit refuzues janë të elaboruara në seksionin III më poshtë.

## **II. VENDIMI ËSHTË NJERRË NË KUNDËRSHTIM ME DISPOZITAT QË RREGULLOJNË FORMËN APO ELEMENTET E DETYRUESHME TË AKTIT ADMINISTRATIV**

15. Sipas nenit 47, paragrafi 1.3 i Ligjit për Procedurën Administrative, përcaktohet se "pjesa arsyetuese" e aktit administrativ është element i detyrueshëm i aktit administrativ të shkruar. Ndërkaq neni 48 i Ligjit për Procedurën Administrative, përcakton se çfarë duhet të përmbajë arsyetimi i aktit administrativ.

### **Neni 48**

#### **Arsyetimi i një akti administrativ me shkrim**

"1. Arsyetimi i siguron palës mundësinë që ta kuptojë aktin administrativ. Arsyetimi përmban:

- 1.1. paraqitje të shkurtër të kërkesës së palës;
- 1.2. shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën është marrë vendimi;
- 1.3. shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave;**
- 1.4. bazën ligjore të vendimit dhe arsyen pse është e zbatueshme në rastin konkret;**
- 1.5. shkaqet për të cilat nuk është pranuar ndonjëri nga pretendimet e palëve;

1.6. në rastin e ushtrimit të diskrecionit, shpjegimin pse është ushtruar ai në mënyrën e dhënë në vendim.

**2. Një arsyetim që është dukshëm i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërthënës apo i pakuptueshëm, është i barabartë me mungesën e tij."**

16. Në arsyetimin e Vendimit refuzues theksohet si vijon:

"Shtetasja nuk i plotëson kushtet dhe procedurat e Ndërrimit dhe Korrigjimit të Emrit Personal, Komisioni ka vlerësuar se arsyeshmëria e ofruar nga parashtruesja e kërkesës nuk qëndron dhe nuk e përmbush qëllimin e nenit 6, paragrafit 1, nënparagrafi 1.8, pasi që emri "Blerta" nuk e pengon integrimin e personit në shoqëri në Republikën e Kosovës, me Udhëzimin Administrativ (MPB) nr.19/2015,.. nga shkaqet e arsytet e cekura më lartë u vendos si ne dispozitivin e këtij Vendimi."

17. Vendimi nuk jep arsyetim të mëtjshëm në lidhje me asnjërin nga argumentet e paraqitura në kërkesë, e as nuk e arsyeton se përse Komisioni i Zyrës së Gjendjes Civile vlerëson se arsyeshmëria e ofruar në Kërkesën për Ndërrimin e Emrit dhe Shënuesit të Gjinisë nga Ankuesi, nuk qëndron dhe nuk e përmbush qëllimin e nenit 6, paragrafit 1.8 të Udhëzimit Administrativ për Ndërrimin e Emrit Personal. Vendimi refuzues nuk shpjegon se është qëllimi i nenit 6, paragrafit 1.8 të Udhëzimit Administrativ për Ndërrimin e Emrit Personal sipas Komisionit të Zyrës së Gjendjes Civile. Poashtu Vendimi nuk shpjegon se me çfarë interpretimi të qëllimit të kësaj dispozite kemi të bëjmë në këtë rast. Duke qenë se në bazë të legjislacionit në fuqi në Republikën e Kosovës, identiteti gjinor është kategori ligjore e mbrojtur, si me Ligjin për Barazi Gjinore, Ligjin për Mbrojtje ndaj Diskriminimit ashtu edhe me praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, arsyetimi i ofruar nga Komisioni i Zyrës së Gjendjes Civile në lidhje me kërkesën për ndërrim të emrit dhe të shënuesit të gjinisë është i papranueshëm. Mospërputhja e emrit dhe shënuesit të gjinisë së personit në dokumente të identifikimit dhe identiteti gjinor me të cilin personi jeton dhe paraqitet në jetën e përditshme e pengon integrimin e plotë të personit në shoqëri dhe e vë atë në një pozitë të vështirë e të marginalizuar. Ky interpretim i të drejtës në identitet gjinor dhe njohjes ligjore të identitetit gjinor është pranuar edhe nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut në rastet e përshkruara në seksionin III.

18. Për më tepër, Vendimi refuzues nuk i paraqet shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave nga Komisioni i Zyrës së Gjendjes Civile, nuk e paraqet bazën ligjore të vendimit dhe arsyen pse është e zbatueshme në rastin e paraqitur para tyre. Asnjë nga

pretendimet e paraqitura në kërkesë nuk është trajtuar në arsyetim dhe nuk janë dhënë shkaqet për të cilat nuk janë pranuar ato pretendime, as për kërkesën për ndërrim të emrit e as për kërkesën për ndërrim të shënuesit të gjinisë në Regjistrin e Gjendjes Civile. Arsyetimi i paraqitur në Vendimin refuzues është dukshëm i pamjaftueshëm, i paqartë dhe i pakuptueshëm andaj sipas nenit 48, paragrafi 2 duhet të cilësohet si i barabartë me mungesën e tij. Rrjedhimisht, Vendimi refuzues nga Komisioni i Zyrës së Gjendjes Civile është njërrë në kundërshtim me dispozitat që rregullojnë formën apo elementet e detyrueshme të aktit administrativ dhe është i paligjshëm sipas nenit 48, paragrafi 1.5 të Ligjit për Procedurën Administrative.

### **III. VENDIMI PËR REFUZIMIN E KËRKESËS ËSHTË NXJERRË NË KUNDËRSHTIM ME LIGJIN MATERIAL**

19.Vendimi refuzues është i paligjshëm sipas nenit 52, paragrafi 1.5 i Ligjit për Procedurën Administrative sepse është nxjerrë në kundërshtim me ligjin material dhe si i tillë, në rastin konkret është diskriminues. Përkatësisht, Vendimi refuzues është i paligjshëm sepse është nxjerrë në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, Ligjin Nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore (në vazhdim "**Ligji për Barazi Gjinore**"), Ligjin Nr.05/L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi (në vazhdim "**Ligji për Mbrojtje nga Diskriminimi**"), Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut, Paktin për të Drejtat Civile dhe Politike, Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

20.Organet e administratës, duke përfshirë këtu Zyrën e Gjendjes Civile dhe Agjencionin për Regjistrimin Civil e ushtrojnë pushtetin shtetëror në raport me qytetarët të cilët atyre iu drejtohen me kërkesa për realizimin e të drejtave të tyre. Andaj e kanë për detyrë t'i mbrojnë, garantojnë dhe respektojnë të drejtat dhe liritë fundamentale të garantuara me Kushtetutë dhe ligjet në fuqi në Republikën e Kosovës. Parimi i barazisë dhe mosdiskriminimit është i integruar në tërë sistemin legjislativ të Kosovës, ndërsa përgjegjësia e organeve administrative gjatë vendimmarrjes parashihet në nenin 6 të Ligjit për Procedurën Administrative, ku përcaktohet si vijon:

#### **"Neni 6**

##### **Parimi i barazisë dhe mosdiskriminimit**

1. Organi publik vepron në pajtim me parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit.
2. Personat në të njëjtën situatë trajtohen në mënyrë të njëjtë. Dallimi në trajtimin e çështjeve justifikohet vetëm nëse dhe për aq sa ai përputhet me ndryshimet objektive të

çështjeve përkatëse.

**3. Organi Publik, në mënyrë të veçantë, shmang çdo diskriminim të padrejtë ashtu siç përcaktohet me Ligjin kundër diskriminimit."**

21. Sipas nenit 3, paragrafit 2 të Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi, **diskriminimi** definohet si vijon:

"Diskriminim është **çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë në çfarëdo baze të përcaktuara në nenin një (1) të këtij Ligji**, që ka për qëllim apo efekt të zhvleftësoj ose cënoj **njohjen, gëzimin ose ushtrimin**, në të njëjtën mënyrë me të tjerët, **të të drejtave dhe lirive themelore të njohura nga Kushtetuta dhe ligjet tjera të aplikueshme në Republikën e Kosovës.**"

22. Vendimi refuzues i Kërkesës për Ndërrimin e Emrit dhe të Shënuesit të Gjinisë është diskriminues sepse ia mohon Ankuesit të drejtën që t'i njihet ligjërisht identiteti i tij gjinor dhe të reflektohet identiteti i tij gjinor në regjistrin civil dhe në dokumentet tjera të tij të identifikimit. Identiteti gjinor është i mbrojtur nga Ligji për Mbrojtje nga Diskriminimi, Ligji për Barazi Gjinore, Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Pakti për të Drejtat Civile dhe Politike, Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut dhe praktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

23. Gjegjësisht, sipas nenit 3, paragrafi 1.3 të Ligjit për Barazi Gjinore, "gjinia mashkullore" definohet si: **"çdo person që e konsideron veten si të tillë pavarësisht moshës dhe statusit martesor"**. Pra në këtë definicion nuk hyn përcaktimi i seksit që personi ka pasur në lindje, por me rëndësi është vetëm përceptimi subjektiv i gjinisë apo gjinia të cilën personi e konsideron si të veten. Andaj kërkesa për ndryshimin e emrit dhe të shënuesit të gjinisë në dokumente të identifikimit është dashur të aprovohet si e bazuar sepse përcaktimi i gjinisë në dokumente duhet të përshtatet me atë gjini me të cilën personi identifikohet.

24. Më tutje, kërkesa për ndërrim të emrit dhe të shënuesit të Gjinisë është dashur të pranohet si e bazuar për shkak se identiteti gjinor sipas ligjeve në fuqi në Kosovë është kategori e mbrojtur ligjore sipas Ligjit për Barazi Gjinore dhe Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi. Sipas nenit 3, paragrafi 1.9 Ligjit për Barazi Gjinore përcakton definicionin e identitetit gjinor si vijon:

**"Identiteti gjinor** - kjo karakteristikë e mbrojtur mbulon identitetin që ka të bëjë me gjininë e një personi, dukjen apo karakteristikat tjera që lidhen me



gjininë e një personi (qoftë përmes ndërhyrjes kirurgjike apo jo) duke mos marrë parasysh seksin që personi e ka pasur në lindje.”

Ndërkaq sipas nenit 1 të Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi, diskriminimi në bazë të **identitetit gjinor** gëzon mbrojtje ligjore njësoj si bazat tjera të diskriminimit të numëruara në këtë nen.

25. Përkatesisht, obligimet pozitive të shteteve në raport me njohjen ligjore të identitetit gjinor te personat transgjinor burojnë pikë së pari nga Neni 6 i Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut e cila e garanton të drejtën e njohjes së personit para ligjit dhe përcakton: **“Gjithkush ka të drejtë që t'i njihet kudo personaliteti juridik”**. Pastaj, neni 3 Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut dhe neni 9 i Paktit për të Drejtat Civile dhe Politike mbrojnë **integritetin trupor në kuadër të së drejtës për liri dhe siguri të personit**, ndërkaq Neni 12 Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut dhe neni 17 Paktit për të Drejtat Civile dhe Politike **mbrojnë të drejtën në jetën private**. E drejta e respektimit të jetës private dhe familjare është e drejtë e garantuar edhe me nenin 36 të Kushtetutës së Kosovës edhe me nenin 8 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut ku përcaktohet si vijon:

#### Neni 8

“1. Çdokush ka të drejtën e respektimit të jetës së tij private dhe familjare, banesës dhe korrespondencës së tij.

2. Autoriteti publik nuk mund të ndërhyjë në ushtrimin e kësaj të drejte, përveçse në shkallën e parashikuar nga ligji dhe kur është e nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit publik, shëndetit ose moralit ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të tjerëve”.

26. Vendimi refuzues ndaj Kërkesës për Ndërrimin e Emrit dhe të Shënuesit të Gjinisë për Ankuesin, çënon të drejtat fundamentale të garantuara me Kushtetutën së Kosovës veçanërisht sepse është nxjerrë në kundërshtim me praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, e cila sipas nenit 53 të Kushtetutës së Kosovës ka karakter detyrues në interpretimin e të lirive dhe të drejtave të njeriut në Kosovë. Obligimet pozitive të shtetit të Kosovës për sigurimin dhe garantimin e të drejtës në jetë private i garantojnë Ankuesit të drejtën që t'i njihet identiteti i tij gjinor dhe i njëjti të reflektohet në të gjitha dokumentet e tij të identifikimit bashkë me emrin me të cilin ai identifikohet në të gjitha sferat e jetës.

27. Në vitin 1992, në rastin *B. kundër Francës*, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut për herë të parë ka vendosur se ka pasur shkelje të së drejtës për respektimin e jetës private dhe familjare

nga neni 8 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në rastin kur autoritetet franceze ia kanë refuzuar ndryshimin e gjinisë në regjistrin e gjendjes civile një aplikuese transgjinore (nga mashkull në femër).<sup>1</sup> Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut në këtë rast ka vendosur se refuzimi për ndryshimin e gjinisë në regjistrin civil ka shkaktuar që aplikuesja të vendoset në një situatë të përditshme e cila nuk siguron respektin e duhur për jetën e saj private, duke qenë se shënuesi i gjinisë në dokumente të identifikimit ishte në mospërputhje me gjininë me të cilën paraqitej aplikuesja.<sup>2</sup>

28. Në vitin 2002 është marrë vendimi për rastin *Christine Goodwin kundër Britanisë së Madhe*, i cili njeherësh është edhe një ndër vendimet kryesore në lidhje me obligimet pozitive të shtetit për njohjen ligjore të gjinisë sipas identitetit gjinor.<sup>3</sup> Në këtë vendim Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut ka krijuar precedentin me të cilin ka vendosur se mosnjohja e gjinisë nga Britania e Madhe me të cilën aplikuesja identifikohet paraqet shkelje të të drejtave të njeriut të mbrojtura me nenin 8 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut – e drejta në jetën private dhe familjare, si dhe nenit 12 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut që e garanton të drejtën në martesë dhe në krijimin e familjes.<sup>4</sup> Gjykata vendimin e ka marrë duke u theksuar se nuk ka faktor të rëndësishëm të interesit publik të cilat do të peshonin më shumë se interesi individual i aplikueses për t’ia njohur ligjërisht gjininë e ri-caktuar.<sup>5</sup>

29. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut ka theksuar se “nocioni i autonomisë personale është princip i rëndësishëm që e përcakton interpretimin e garancioneve nën nenin 8” (Pretty, §61, Van Kück, §69, dhe Schlumpf §100), dhe se “e drejta në identitet gjinor dhe në zhvillim personal është aspekt fundamental i të drejtës në jetë private” (Van Kück, §75). Vendime të tjera ku Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut ka rikonfirmuar obligimin pozitiv të shtetit për respektimin e jetës private përmes njohjes ligjore të gjinisë me të cilin personi identifikohet dhe vendosjes së procedurave që e rregullojnë njohjen ligjore të gjinisë janë: *I. kundër Britanisë së Madhe*, nr.25680/94, GJEDNJ 1994; *Grant kundër Britanisë së Madhe*, nr.32570/03, 2006; *A.P., Garçon dhe Nicot kundër Francës*, nr.79885/12, 2017.

30. Pas shqyrtimit të kësaj ankese dhe të argumenteve të paraqitura më sipër, kërkojmë nga Agjencioni për Regjistrimin Civil që, sipas nenit 131, paragrafi 4 dhe 5 të Ligjit për Procedurën Administrative, të nxjerrë këtë:

---

<sup>1</sup> *B. kundër Francës*, nr.13343/87, GJEDNJ 1992.

<sup>2</sup> *Ibid*, paragrafi 63.

<sup>3</sup> *Christine Goodwin kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr.28957/95, GJEDNJ 2002.

<sup>4</sup> *Ibid*, paragrafi 93, 104, 104.

<sup>5</sup> *Ibid*, paragrafi 93 i Vendimit.

## AKTVENDIM

- I. APROVOHET si tërësisht e bazuar ankesa e Blerta Morina, ndaj Vendimit Nr.02-201-02-8319, i datës 26.04.2018 të Zyrës së Gjendjes Civile në Gjakovë për Refuzimin e ndërrimit të emrit nga "Blerta" në "Blert" dhe ndërrimit të shënuesit të gjinisë nga "F" në "M".
- II. ANULOHET Vendimi Nr.02-201-02-8319, i datës 26.04.2018 i Zyrës së Gjendjes Civile nga Komuna e Gjakovës për Refuzimin e ndërrimit të emrit nga "Blerta" në "Blert" dhe ndërrimit të shënuesit të gjinisë nga "F" në "M".
- III. URDHËROHET Zyra e Gjendjes Civile në Komunën e Gjakovës që t'i regjistrojë ndërrimet në Regjistrin e Gjendjes Civile në përputhje me këtë Aktvendim.

Rina Kika

Avokate

---

(sipas autorizimit në shkresa të lëndës)